REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 643/20
Data/Datum. 10.09.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A.nr.643/20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër te protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë"**, me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 09 SHTATOR 2020 mori këtë :

VENDIM

I. **Hedhet si e jashtafatshme** ankesa e OE **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, e dorëzuar në mënyrë elektronike me datën 07.09.2020 në ora 16:04 minuta, ndërsa është protokolluar me datën 08.09.2020 me nr. të protokolli. 643/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë"**, me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-**

5-1-1, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë".

II. **I LEJOHET** Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Pejë, që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë"**, me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë", përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.

IV. **Obligohet,** OE ankues që konform nenit 31 pika 6-të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Më datën 07.09.2020 në ora 16:04 minuta, në mënyrë elektronike, OSHP ka pranuar ankesën me numër të protokolli. 643/20, e cila ankese është protokolluar me datën 08.09.2020, sipas orarit zyrtar, ankesë kjo e parashtruar nga ana e OE **"Mirusha Company" SH.P.K. – Klinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë"**, me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë".

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, me nr. të protokolli. 643/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit:

"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë", me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë" dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lëndës si dhe në platformën e e-prokurimi kjo ankesë rezulton të jetë parashtruar pas kalimit të afatit ligjor në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se Autoriteti Kontraktues (AK) "Kuvendi Komunal Pejë" për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë",** me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, me Njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës dhe me Letrën Standarde e ka njoftuar OE ankues me dt.18.08.2020.
Kundër Njoftimit të lartcekur Operatori Ekonomik (OE) ankues ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim të vendimit të AK-së me dt. 24.08.2020.
AK me dt.27.08.2020, e ka njoftuar OE ankues me vendim për refuzim si të pabazuar të Kërkesës për Rishqyrtim .

Kundër vendimit te lartcekur OE ankues "Mirusha Company" SH.P.K. – Klinë, më datën 07.09.2020 në ora 16:04 minuta, në mënyrë elektronike, parashtron ankesë në OSHP , ku OSHP të njëjtën ankesë e protokollon me datën: 08.09.2020 me numër të protokollit 643/20.

Andaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pas parasysh faktin se AK me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, e ka njoftuar OE ankues më dt.27.08.2020, afati ligjor sipas LPP-së , për parashtrim të ankesës në OSHP ka filluar të rrjedh nga data 28.08.2020,nga ora 08:00 deri në ora 16:00, dhe ka përfunduar me datën 06.09.2020 ora 16:00 (duke pasur parasysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).Si dhe duke e pas parasysh nenin 5 të LPP-së përkatësisht pika II e specifikon citat " **2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj**. Në rastin konkret dita e pare ka gjen data 07.09.2020, por OE, e ka humbur afatin kohor i cili ka qen deri ne ora 16:00.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE: **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, ka humbur afatin ligjor për parashtrim të ankesës në OSHP andaj ankesa e parashtruar me datën

07.09.2020, në ora 16:04h, e protokollua me datën 08.09.2020 me numër të protokollit 643/20, nuk mund të shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si e jashtafatshme .

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si me lartë OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në mënyrë elektronike nga OE: **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë** e me datën 07.09.2020, në ora 16:04 minuta dhe e protokolluar nga OSHP me dt.08.09.2020, me numër te Protokollit 643/20, hedhet si e jashtafatsheme sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK –Kuvendi Komunal Pejë.
1x1 OE "Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë
1x1 Arhivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së